



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 11.01.2023, nxjerrë këtë:

REPUBLIKA E KOSOVËS AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT AGENCIJA ZA SPRJEČAVANJE KORUPCIJE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION	
Dep. Dop. Dep.	Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.
DPKI	06-02/71123
Nr. i Faq. Br. Str. Nr. Page.	Dots Datum Date
02	17.01.2023
PRISHTINË	

V E N D I M

- Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-4056/22, për zyrtarin e lartë z. Enver Peci, ish-anëtar i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.**

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Enver Peci, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas pranimit të informatës nga raportuesi i jashtëm, ka filluar trajtimin e këtij rasti me pretendimin për konflikt të interesit sipas të cilit, z. Enver Peci, si anëtar i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, ka marrë pjesë në vendimmarrje në konflikt të interesit me rastin e miratimit të listës së trajnerëve, nder të cilët ka qenë edhe djali i këtij të fundit z. Shpëtim Peci.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (DPKI-06-02-4450/22).

Më pastaj, Agjencia ka kontaktuar me z. Peci, me ç'rast e ka njoftuar me pretendimet e ngritura lidhur me situatën e mundshme të konfliktit të interesit, si dhe ka dëgjuar sqarimet e tij lidhur me pretendimet në fjalë. Ndër të tjera ai ka sqaruar se z. Shpëtim Peci është angazhuar si trajner përmes një programi të UNDP-së, për 4 sesione trajnuese, dhe se përzgjedhja e tij nuk ka kaluar përmes Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë.

Lidhur me këtë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit përmes shkresës zyrtare (DPKI-06-02/4674/22) ka kërkuar dokumentacione dhe informacione shtesë nga Akademia e Drejtësisë.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit dhe informacioneve të siguruar nga Akademia e Drejtësisë (DPKI-06-02/4674-1/22), pastaj dispozitave ligjore përkatëse si dhe sqarimeve nga pala, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka gjetur se z. Enver Peci ka marrë pjesë në vendimmarrje në konflikt të interesi, andaj, në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për konflikt të interesit, për faktin se:

Me Rregulloren Nr. 02/2019 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë, janë të përcaktuar dy lloje të trajnuesve, dhe atë trajnues të përkohshëm dhe trajnues të përhershëm, të cilët mund të angazhohen në Akademi pas miratimit nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë. (neni 4 paragrafi 1, neni 6 paragrafi 2 dhe neni 9 paragrafi 10)

Ndërsa në bazë të dokumentacionit të siguruar nga Akademia e Drejtësisë (DPKI-06-02/4674-1/22), z. Shpëtimi Peci nuk figuron në listën e trajnuesve të përhershëm e as në atë të trajnuesve të përkohshëm, e të cilat lista aprovohen nga ana e Këshillit Drejtues të Akademisë.

Sipas Akademisë së Drejtësisë (02/332/2022), Shpëtim Peci ka qenë i angazhuar për katër ditë trajnimi (mars-maj 2022), në Programin trajnues të Akademisë së Drejtësisë për bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjorë në kuadër të sistemit gjyqësorë dhe prokurorial, përmes projektit të UNDP dhe AD – “Mbështetja në funksionalizimin e institucioneve për sundimin e ligjit dhe përmisimi i qasjes në drejtësi”. Si rrjedhojë, z. Shpëtim Peci është angazhuar në cilësinë e trajnerit për ofrimin e trajnimeve për bashkëpunëtor profesional dhe zyrtarë ligjor, projekt i mbështetur dhe financuar nga UNDP dhe atë në 4 sesione, ku ka bashkë-trajnuar me trajnerët e përkohshëm.

Andaj, nga sa u tha më lartë, në rastin konkret nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, ashtu siç është përcaktuar me neni 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, respektivisht, “Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare.”

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Buleshkaj
Drejtues i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

